

VENDIM
Nr. 303, datë 21.5.2014

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE PROKURORIA E PËRGJITHSHME, TË MJEDISEVE DHE SIPËRFAQES 342 m², TË PRONËS NR. 3/31, NË ZONËN KADASTRALE NR. 8582, ME EMËRTIM “GODINA E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR POGRADEK”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1292, DATË 24.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË APELIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Prokuroria e Përgjithshme, të mjediseve dhe sipërfaqes 342 (treqind e dyzet e dy) m², të pronës nr. 3/31, në zonën kadastrale nr. 8582, të objektit dhe të truallit të ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në funksion të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Prona nr. 3/31, me emërtim “Godina e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose ta japin në përdorim të tretët.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANIMETRIA E NDERTESES GJYKATA Pogradec
SH.1:100

Lagja 3

Kati i I

Z.K. 8582




SIP. = 147 m²

Shkollët dhe një pjesë koridori
në hyrje janë të përbashkëta me
Prokurorinë e cilës ka Katin e III (Tretë)

SIP. e shkollëve dhe koridori = 40 m²

Punoi TOPOGRAF Shëfzet Torro
Lib. Nr. T. 0295/1



PLANIMETRIA E NDERTESES — GJYKATA — Pogradec

Kati i II

SH.1:100


Lagja 3

Z.K. 8582

SIP. = 171 m²

Shkallet jone te perbashketa me
Prokurorine e cila ka Katir e III (Trete)

SIP. e shkalleve = 16 m²



Punoi TOPOGRAF Shfaqet Torro
Lidhje Nr. 7 0295/1



